




Republika e Kosovës
Republik of Kosovo
Republika Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
27-10-2021
05-11/01-814



Komuna e Vitisë
Municipality of Vitina
Opština Vitina

DATE/A	27.10.2021
REFERENCË	
PËR(ZA)TO	Publimimi i konkursit publik për mësimdhënës/se
CC:	
PËRMES (PREKO) THROUGH	Drejtorisë së arsimit të Komunës së Vitisë
NGA (OD) FROM	Njësia e Burimeve Njerëzore z.Hysen Ymeri
TEMA (SUBJEKT) SUBJEKT	Konkurs publik për mësimdhënës

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114, neni 67, 68 dhe 69, të Ligjit për arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, si dhe në bazë të nenit 35 të Ligjit mbi arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, Udhëzimit administrativ (MASHT) nr.05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e procedurave të Konkursit Publik në sektorin Publik, **Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vitisë shpall:**

KONKURS PUBLIK

SHFMU, „Dom Mikel Tarabolluzi” në Stubell e Epërme

-Një (1) arsimtar për lëndën Gjuhë angleze **zv.me** kohë të caktuar, deri në kthimin e puntorës nga pushimi i lehonisë.

SHFMU, „Halil Alidema” në Pozhoran

-Një (1) arsimtar për lëndën Kul.Figurative **zv.me** kohë të caktuar, deri në kthimin e puntorës nga pushimi papagesë.

SHML.Gjimnazi, „Kuvendi i Lezhës” në Viti

-Një (1) profesor për lëndën Gjuhë Gjermane **zv.me** kohë të caktuar, deri në kthimin e puntorës nga pushimi i lehonisë.

-Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim:

- Formulari i aplikimit i cili merret në zyrën e Arkivit të Komunës,
- Diploma (çertifikatën e diplomimit jo më e vjetër se 6 muaj) e fakultetit e vërtetuar te noteri.
- Fotokopjen e leternjoftimit,
- Vërtetimin e përvojës së punës,
- Vërtetimin nga gjykata, se nuk është nën hetime,
- Të diplomuarit jashtë vendit, diplomat e tyre të nënshtrohen proqesit të nostifikimit nga Masht-i.

Kandidatët të cilët konkurojnë në pozitat mësimdhënës, duhet të kenë përgaditjen përkatëse profesionale, fakultetin (diplomën). Në mungesë të kandidatëve me përgaditje përkatëse profesionale do të mirren në shqyrtim kandidatët me përgaditje përkatëse profesionale më të ulët, sipas udhëzimit administrativ të MASHT-it nr.05/2021, për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.

Kandidatët e interesuar për aplikim, aplikacionet i marrin dhe i dorëzojnë në Arkivin e Komunës së Vitisë. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, sipas Ligjit për Zyrat Publik.

Afati i konkursit është 15 ditë nga data e publikimit në tabelën e shpalljeve, web faqen e Komunës, duke filluar nga data 27.10.2021 deri më 10.11.2021.

Kandidatët-aplikantët të cilët kanë konkuruar, i njoftojmë se pas mbylljes së konkursit, do të nënshtrohen intervistës me shkrim dhe gojë.

Më: 27.10.2021.Viti

Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore

